




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



DREJTORIA E BUJQËSISË

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të gjithë fermerët e Komunës së Prishtinës të aplikojnë për skemat e përkrahjes në sektorin e bujqësisë, për pajisjet të cilat ndodhen në deponë e Komunës së Prishtinës nga vitet paraprake.

1. Furnizimi me makina mjelëse dhe bidona për lopë qumështore, dele dhe dhi. Gjithësej 8 makina mjelëse (4 copë për gjedhe qumështore dhe 4 copë për kafshë të imëta).

Kriteret ;

- Të kenë 3 e më shumë krerë gjedhe qumështore;
- Të kenë nga 10 e më shumë krerë dele qumështore;
- Të kenë nga 10 e më shumë krerë dhi qumështore;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara;
- Përfituesi duhet të jetë banor rezident i komunës së Prishtinës, si dhe objekti (stalla) për vendosjen e gjedheve, deleve dhe dhive të jetë në territorin e komunës së Prishtinës;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Përparësi do të kenë fermerët që nuk kanë qenë asnjëherë përfitues i paisjeve dhe mekanizmit bujqësor në sektorin e blegëtorisë
- Fermerët që kanë numër më të madh të krerëve të gjedheve, deleve dhe dhive qumështore kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël dhe
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Vërtetim nga shërbimet veterinare të licencuara nga organet përkatëse.

2. Përkrahje në bletari – furnizimi me pajisje bletare (centrifugë elektrike -2 copë, bluzë të bletarit - 1 copë, depozitor inox -1 copë)

Kriteret :

- Përfituesi duhet ta ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banor rezident i saj;
- Përkrahen bletarët që kanë 10 e më shumë shoqëri bletësh;
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët kanë përfituar pajisje të bletarisë nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Bletarët që kanë numër më të madh të shoqërive të bletëve kanë përparësi në raport me ata që kanë numër më të vogël dhe
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;

Dokumentacioni:

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Deklarata e bashkësisë familjare;

VËREJTJE

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar që t'i sjellë ato në afatin i cili i caktohet, në të kundërtën humb të drejtën për të qenë përfituesi i subvencionit (grantit).

Data e aplikimit, prej 11/12/2023 deri më 13/12/2023